



Liridona

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	16.08.2021
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	Youth Initiative for Human Rights
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike <i>Kastrati</i> Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorija për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga Youth Initiative for Human Rights me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike në sheshin “Skënderbeu” me datë 30.08.2021 nga ora 12:00 deri në ora 20:00. Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të zhdukjeve të dhunshme planifikohet të organizohet aksion rrugor i cili do të realizohet përmes 22 siluetave të kartonit të cilat do të jenë simbolikë e njëzet e dy (22) viteve në pritje të familjarëve ende të pagjetur si dhe pritjes ndaj qeverisë për të ndërmarrë hapa serioz ndaj kësaj çështje.

Drejtorija pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “Skënderbeu” me datë 30.08.2021 nga ora 12:00 deri në ora 20:00, ku me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Zhdukjeve të Dhunshme planifikohet të organizohet aksion rrugor i cili do të realizohet përmes 22 siluetave të kartonit të cilat do të jenë simbolikë e njëzet e dy (22) viteve në pritje të familjarëve ende të pagjetur si dhe pritjes ndaj qeverisë për të ndërmarrë hapa serioz ndaj kësaj çështje.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.